



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 70

Prishtinë, më 17.6.2016, në orën 15:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Selvie Halimi, Danush Ademi, Agim Aliu, Armend Zemaj, Agim Ademaj, Nezir Çoçaj dhe Milena Miliçević.

Munguan: Albulena Haxhiu, Doruntinë Maloku, Valdete Bajrami dhe Donika Kadaj-Bujupi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Adem Gashi – US Embassy, Dona Lluka RTV Dukagjini, Lumnije Berisha – OSBE, Agnesa Haxhiu – KDI, Blerta Bejtullahu, EUSR/EV Office, Besnik Tahiri – Klan Kosova dhe Albert Ahmeti – Zëri.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Mbledhjen e kryesoi, Selvije Halimi, nënkryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-103 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlihen me mandatin e misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-103 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës

Kryesuesja paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 05/L-103 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës. Ajo propozoi amendamente si vijon:

Amendamenti 1

Në tërë tekstin e Projektligjit fjalët EULEX, EULEX-in, EULEX-it, në kontekst të fjalisë kur i referohet institucionit zëvendësohen me “EULEX KOSOVA”.

Amendamenti 2

Në **nenin 4** të Projektligjit paragrafi 3.5 fjalët “ **paragrafit 4 një të këtij neni**” zëvendësohen me “ **paragrafit 3.4 të këtij neni**” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 3

Neni 10 i Projektligjit në rreshtin e pestë fjalët “Presidenti i Dhomës” zëvendësohen me “ Kryetari Dhomës” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Meqë nuk kishte vërejtje të tjera, kryesuesja konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

Rekomandim

- I. Të miratohet Projektligji nr. 05/L-103 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës, me amendamentet e propozuara.*
- II. I rekomandohet zyrës për Standardizim, Përafrim dhe Harmonizim Ligjor që teksti gjuhës serbe dhe angleze të harmonizohen me tekstin në gjuhën shqipe.*

Mbledhja përfundoi në orën 15:35

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Nënkryetarja e Komisionit,

Selvije Halimi